



KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		06/10/	20 25
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	060/04-	44110	

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas –Municipality of Drenas



PROCESVERBAL I DËGJIMEVE BUXHETORE

Vendi: SHFMU “Xheladin Gashi-Plaku”, Komoran Datë: 20.08.2025 Ora: 17:30

Dëgjimet buxhetore në Komoran u mbajtën më 20 gusht 2025, ku morën pjesë përfaqësues nga fshatrat Komoran I, II, III dhe IV, Zabel i Ulët dhe i Epërm, Korroticë e Epërme, Fushticë e Ulët dhe e Epërme, Sankoc, Nekoc dhe Kishnarekë. Në këtë dëgjim buxhetor, nga Komuna ishin të pranishëm:

Ramiz Lladrovci	Kryetar i Komunës
Arben Shala	Nënkryetar i Komunës
Muhamet Gjoka	Drejtor i Drejtorisë për Arsim,
Endrit Gllareva	Drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Publike
Nexhmedin Gruda	Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, dhe UD i Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
Kushtrim Bajraktari	ZKF-Zyrtar Kryesor Financiar
Bekim Dobra	Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun

Rendi i ditës

Dëgjimi Buxhetor filloi me këtë rend dite:

1. Prezantimi i projeksioneve buxhetore për vitet 2026–2028,
2. Pranim dhe shqyrtimi i kërkesave,
3. Çështje të ndryshme.

Hyrje

Prezantimi i projeksioneve buxhetore për vitet 2026–2028

Hapjen e dëgjimit buxhetor e bëri **Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, z. Bekim Dobra**. Në fjalën e tij hyrëse, ai theksoi rëndësinë e organizimit të dëgjimeve buxhetore si mekanizëm i transparencës dhe i përfshirjes së qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor. Po ashtu, ai prezantoi rregullat dhe procedurat që do të ndiqeshin gjatë zhvillimit të këtij dëgjimi.

Tutje, fjalën e mori **Kryetari i Komunës, z. Ramiz Lladrovci**, i cili përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi qytetarët për pjesëmarrjen aktive në këtë proces. Ai theksoi se dëgjimi ka për qëllim shpalosjen e projeksioneve buxhetore për vitet 2026–2028, si dhe mbledhjen e kërkesave e propozimeve nga qytetarët për projektet e nevojshme në komunitet.

Kërkesat

Pranim dhe shqyrtimi i kërkesave

Pas fjalës përshëndetëse të Kryetarit Lladrovci, fjalën e morën përfaqësuesit e fshatrave të këtyre lokaliteteve, të cilët parashtruan kërkesat e tyre.

Përfaqësuesit e fshatrave paraqitën kërkesat e tyre. Në total u parashtruan tri kërkesa kryesore: Ndriçim publik, Infrastrukturë rrugore, Ujësjellës dhe kanalizim.

Kërkesat u pranuan dhe u regjistruan, ndërsa u dhanë përgjigje të përgjithshme nga kryetari i komunës dhe drejtorët përkatës.

Tabela e kërkesave dhe përgjigjeve

Përfaqësues / Banor	Lokaliteti	Kërkesa	Përgjigja / Sqarimi nga institucioni
Besim Nishori	Rruga Xheladin Gashi Fshati Komoran	Kërkesa: Ndriçim dhe kanalizim përgjatë rrugës. Rregullimi i parkut të pishave, shtratit të lumit dhe kanaleve kulluese. Informata shtesë: deri ku ka shkuar projekti i shkollës dhe stacioni policor.	Kryetari: Për parkun e pishave është ndarë buxhet prej 150,000 €, por mjetet janë marrë nga procedurat përmbarimore. Për rrugën Xheladin Gashi janë ndarë 60,000 €. Ndriçimi do të vendoset aty ku ka shtylla betoni. Trotuarët do të vendosen vetëm në pronat publike, pasi në pronat private nuk mund të shpronësohet për shkak të koston. Shtrati i lumit është rregulluar. Sa i përket shkollës, ajo ka pasur problem pronësor, por së shpejti do të funksionalizohet si shkollë profesionale me interesim nga e gjithë Kosova. Stacioni i Policisë është në rinovim nga vetë Policia; aty do të vendoset Njësia e Trafikut Rajonal dhe një njësi nga Stacioni i Policisë së Drenasit.
Veton Morina	Lagjja Zogu	Asfaltimi i rrugës (210m), rrugë private.	Kryetari: Rruga është pronë private dhe nuk guxohet të asfaltohet.

Xhafer Doberdolani	Zabel i Epërm	Asfaltimi i një rruge, mungesë ndriçimi. Po ashtu edhe për Korroticën e Epërme: asfaltimi i rrugicave, ndriçimi dhe kanalizimi për disa shtëpi. Mungon asfaltimi i rrugës deri te shkolla.	Kryetari: Edhe pse procedurat përmbartimore kanë marrë 297,000 €, prapë jemi duke punuar dhe do të kryhen edhe këto punime.
Kadri Ajazi	Sankoc, Fushticë e Epërme dhe e Ulët	Në Sankoc mungojnë trotuarët, sidomos një pjesë deri te shkolla; kërkohet asfaltimi i rrugicave. Në Fushticë të Epërme: sanimi i kanalizimit që rrjedh nga fshati Mirenë (Komuna e Lipjanit) dhe kalon nëpër fushat e 10 shtëpive të Fushticës së Epërme. Po ashtu, sanimi i kanalizimit afër shkollës në lagjen Osmani.	Edhe pse kemi buxhet të kufizuar për shkak të procedurave përmbartimore, këto punë janë planifikuar dhe do të adresohen me prioritet.
Selman Pirraku	Lagja Pirraku, Sankoc	Asfaltimi i dy rrugicave. Furnizim me energji elektrike mungon në disa shtëpi.	Për furnizimin me energji elektrike duhet të drejtoheni tek KEDS.
Ymri Bajraktari	Kishnarekë	Asfaltimi i disa segmenteve rrugore: Rr. Fehmi Bajraktari dhe Fehmi Mialim Qelaj (pjesët e pa asfaltuara). Ndriçim në pjesët ku mungon (në tri lagje). Mungesë kanalizimi në disa hapësira. Kërkesë që të merret parasysh shtrimi i rrugës që çon tek Malet e Berishës, vend i refugjatëve gjatë luftës dhe i shkronjave të arta të UÇK-së.	Komuna ka investuar në shtrimin e rrugës nga Llapushniku për në Berishë, e cila ka shkurtuar rrugën për më pak se 44 km. Për shkak të procedurave përmbartimore, buxheti është i pamjaftueshëm.

Çështje të ndryshme

Nuk pati pika shtesë për diskutim.


Përfundimi

Meqenëse rendi i ditës u përmyll, dëgjimi buxhetor u shpall i përfunduar.

Kryetari falënderoi pjesëmarrësit për kontributin e tyre.

Numri i Pjesëmarrësve		
M - 23	F - 5	Totali: 28

Procesmbajtësi


Arton Hasani

